



QYTETI I SHKUPIT

Nr. 08-9659/2

30. 08. 2024

Shkup

Në bazë të Nenit 50 paragrafi 1 pika 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02) dhe në lidhje me Nenin 20-g të Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 143/19 dhe 14/20), Qyteti i Shkupit shpall

SHPALLJE PUBLIKE nr.05/2024
për punësimin e punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar

Përcaktohet nevoja për punësimin e punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar për vendin e punës të mëposhtëm:

1. Emërtimi i vendit të punës **Higjienist/e**, shifra UPR 0405A03004, Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, **Numri i përmbauesve (1)**.

Kandidati është e nevojshme t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë nënshkolltar i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë madhore,
- të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës:

Kushte të veçanta:

- më së paku arsim fillor
- me ose pa përvojë pune

Vlera në të holla e pagës bazë neto për vendin e punës Higjienist/e - 27.486,00 denarë.

Orari i kohës së punës - 8 orë në ditë, 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten nga ora 12:30 deri në orën 20:30.

Kandidatët mund ta shkarkojnë **APLIKIMI PËR PUNËSIM të personave ndihmës – teknikë në Qytetin e Shkupit nr.05/2024** nga ueb faja e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk ose ta marrin në Arkivin e Qytetit të Shkupit në barakën nr.16 në adresën Bul. Ilinden nr.82, Shkup.

Kandidatët janë të obliguar përveç aplikimit për punësim sipas shpalljes publike nr.05/2024, t'i depozitojnë edhe dëshmitë për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura në origjinal ose kopje të noterizuara si më poshtë:

- dëshmi për shtetësi;
- dëshmi se me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- dëshmi për përfundimin e nivelit adekuat të arsimit;
- dëshmi për aftësi shëndetësore dhe psikofizike nga institucion i autorizuar shëndetësor në përputhje me ligjin.

Kandidatët nëse kanë përvojë pune është e nevojshme të depozitojnë edhe dëshmi për përvojë pune të evidentuar në Agjencinë e Punësimit.

Vërejtje: Në përputhje me Planin vjetor për punësime në Qytetin e Shkupit për vitin 2024, të shpalljes publike të shpallur për vendin e punës nën numrin rendor 1. **Higjienist/e** – 1 përmbaues duhet të punësohet **1 (një) rom/e**.

Kandidatët e interesuar dokumentet e kërkuara duhet t'i depozitojnë në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka nr.16) ose në adresën bul. "Ilinden" nr. 82, Shkup me shënimin - për **SHPALLJE PUBLIKE nr.05/2024 për punësimin e punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar**.

Afati i aplikimit është 5 ditë pune nga dita e shpalljes së shpalljes publike. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e specifikuara në shpallje në momentin e depozitimit të aplikimit.

Vërejtje: Nëse kandidati në aplikim nuk ka dhënë të dhëna për kontakt (numër telefoni ose adresë e-mail) aplikimi do të refuzohet.

Informacion për mënyrën e realizimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim:

Faza 1: verifikimi i aplikimeve dhe dëshmime – realizohet në një afat prej 3 ditësh nga dita e përfundimit të shpalljes publike. Nëse mungon ndonjë dëshmi, Komisioni përzgjedhës do të kontaktojë kandidatin nëpërmjet adresës e-mail ose numrit të telefonit në aplikim, dhe ai në një afat prej tri ditësh duhet t'i kompletojë dëshmitë, në të kundërt aplikimi do të refuzohet. Aplikimi do të refuzohet edhe nëse dëshmia/dëshmitë janë të rreme.

Faza 2: intervista e kandidatëve të përzgjedhur – realizohet në një afat prej 10 ditësh pas realizimit të fazës së dytë të përzgjedhjes.

Fazat e procedurës për përzgjedhje janë rregulluar në mënyrë të hollësishme në **RREGULLORE për punësimin e personave ndihmës – teknikë në Qytetin e Shkupit**, e cila është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).



QYTETI I SHKUPIT
KRYETARJA E QYTETIT TË SHKUPIT

Danela Arsovska